



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:079512

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06383170

P.nr.1078/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm Penal gjyqtarja e çështjes Laura Hoti Statovci duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.411/24 të datës 22.05.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1369/21 e datës 23.04.2021, kundër te akuzuarve S. H. dhe Rr.B. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datën 31.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja nr. Nd.411/24 të datës 22.05.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarve S. H. dhe Rr. B. në një të ane dhe të dëmtuarit E. A. në anën tjetër.
- II. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.1369/21 e datës 23.04.2021.
- III. PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarve S. H. dhe Rr. B. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se i akuzuari me të dëmtuarin kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1369/21 e datës 23.04.2021 kundër të akuzuarve S. H. dhe Rr. B. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me datë 16.05.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale dhe me dakordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 22.05.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 25.07.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të KPPRK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1078/21 datë 31.10.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe i njëjti do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.